



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 272/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Muhamet Rexha Kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Srdjan Mitrović kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Srpska Lista dega në Gjilan, paraqitur kundër Anëtarit të Këshillit të Vendvotimit Sasha Rizić, për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga Srdjan Mitrović kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Srpska Lista, dega në Gjilan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.06.2014, nga Srdjan Mitrović kandidat nga radhët e Srpska Lista në të cilën pretendohet se gjatë numërimit të rezultateve në vendvotimin Nr.0415D/01R, Sasha Rizić axha i kandidates Marina Rizić me nr.26 nga radhët e Srpska Lista i ka lexuar rezultatet për kandidaten me nr.26, edhe pse kjo kandidate nuk ka qene e votuar ne ato fletëvotime, dëshmitaret pohojnë se kandidatja nr.26 i janë rritur votat për më së paku 50 vota duke i dëmtuar kandidatet tjerë me numra: 15,16,17,48,41, dhe 64, thuhet në pretendimet e ankimore. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur emrat e dy dëshmitareve .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-i me datë 10.06.2014 e informoi Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, për ankesën që është bërë kundër KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet deri më datë 11.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ në të cilën thuhet se ndaj rezultateve preliminare nuk ekziston e drejta e ankesës. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk kanë marrë formën përfundimtare në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e ankesën, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të Nenit 102 paragrafi 1 të LZP-së dhe Nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet " lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 272/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.